

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN- Departamenti për Krime të Rënda, trupi gjyku i përbërë nga gjyqtari Skender Çoçaj, si kryetar i trupit gjyku, dhe gjyqtarët Luan Berisha dhe Xhemil Elshani anëtar, me procesmbajtësen Birsen Kume – sekretare juridike pranë kësaj gjykate, duke vendosur në lëndën penale kundër të akuzuarit M. Q., nga P., për shkak të veprës penale të grabitjes nga neni 329 parografi 1 të Kodit Penal te Kosovës, duke vendosur sipas aktakuzës të PTH-së në Prizren, PP/I.nr.62/2017 te datës 29.08.2017, pas mbajtjes së shqyrimit gjyqësor në prezencën e Prokurorit të Shtetit Ervehe Gashi, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij av.V. O. më datë 05.12.2017, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

M. Q., nga i ati M. dhe e ema Z., e vajzërisë G., i lindur me 18.09.1995 në C.R. RF Gj., tani jeton në P. rrugën “ ” nr. pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 01 shkurt 2017, rreth orës 04:00 në Prizren në rr.“ ”, i dyshuar duke përdorur forcën dhe kanosjen, sulmojnë në shtëpinë e saj viktimën H. T., me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete, në atë mënyrë që në bashkëveprim me të miturin L. duke ditur që viktima jeton vetëm, hyjnë në shtëpinë e të dëmtuarës duke kapërcyer murin rrëthues të oborrit, e duke depërtuar brenda shtëpisë, pasi që thyejnë xhamin e derës së hyrjes, ku në korridore hasin të dëmtuarën të cilës i mituri L. L. ia mbyll gojën, ndërsa i pandehuri M. Q. fillimi shtëpisës së kokën e vet e qet një çorapë, afrohet te viktima dhe me një thikë në dorë e kërcënën dhe i afron të rijejtën në qafë duke i thënë se do ta mbysim dhe nga e njëjtë marrin unazat, një byzylyk dhe vathët që të gjitha të floririt, e pas kontrollimit dhe demolimit të shtëpisë arrijnë të marrin edhe një shumë të hollash prej 6.000 euro (gjashtë mijë euro) një fotoaparat, dy telefonë mobil dhe më pas largohen nga shtëpia.

- Kësot dore ka kryer veprën penale të grabitjes, nga neni 329 parografi 1 të Kodit Penal te Republikës së Kosovës.

- Andaj gjykata në bazë të dispozitave të lartshënuara dhe neneve 7, 41, 42, 43, 45, 46, dhe nenin 329 par. 1 të KP, të akuzuarin e :

G J Y K O N

Me dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tri) vitesh në të cilin dënim do t'i llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga data 04.05.2017 deri më 05.12.2017 dhe;



କୁଳାଳ ପରିମାଣ

କୁଳାଳ ପରିମାଣ

କୁଳାଳ ପରିମାଣ

କୁଳାଳ ପରିମାଣ
କୁଳାଳ ପରିମାଣ

କୁଳାଳ ପରିମାଣ
କୁଳାଳ ପରିମାଣ

କୁଳାଳ ପରିମାଣ
କୁଳାଳ ପରିମାଣ

କୁଳାଳ ପରିମାଣ
କୁଳାଳ ପରିମାଣ

କୁଳାଳ ପରିମାଣ

କୁଳାଳ ପରିମାଣ

Dënim me gjobë në lartësi prej 500 (pesëqind) euro të cilën shumë i akuzuari obligohet ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në rast se i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë apo nuk mundet ta paguaj, dënim me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu që për çdo 20 euro të gjobës do t'i caktohet një ditë burgim.

E dëmtuara H. [REDACTED] për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

I akuzuari obligohet që t'i paguajë të gjitha shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 200 (dyqind) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në [REDACTED] ka parashtruar aktakuzën PP/I.nr. [REDACTED] te datës 29.08.2017 kundër të akuzuarit M. [REDACTED] Q. [REDACTED] për shkak të veprës penale të grabitjes nga neni 329 paragrafi 1-të Kodit Penal te Kosovës. Prokurori i shtetit në fjalën e tij përfundimtare ka dekluaruar se gjatë shqyrtimit kryesor respektivisht seancave të këtij shqyrtimi është vërtetuar gjendja faktike ashtu si është e përshkruar në dispozitivin e aktakuzës. Kjo gjendje faktike është vërtetuar nga provat materiale të propozuara nga prokurori i shtetit dhe të administruara gjatë shqyrtimit kryesor pikërisht pjesërisht nga deklarata e të dëmtuarës pastaj nga deklarata e dëshmitarit B. [REDACTED] G. [REDACTED] i dhe nga provat materiale siç janë vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve të datës 03.05.2017, dosja e forenzikës si dhe provat materiale që janë pjesë përbërëse e çështjes për të mitur, edhe pse këtu i akuzuari M. [REDACTED] Q. [REDACTED] nuk e ka pranuar kryerjen e kësaj vepre penale në shqyrtimin kryesor e as në Prokurori, por në deklaratën e tij të dhënë në polici ka përshkruar se si e ka kryer veprën penale i shoqëruar me të miturin L. [REDACTED] L. [REDACTED]. Deklarata e tij e dhënë në polici është marrë në kuptim të dispozitave të KPP duke i respektuar të drejtat dhe liritë themelore të akuzuarit, kjo deklaratë përkon me deklaratën e të dëmtuarës H. [REDACTED] T. [REDACTED] me foto dokumentacionin nga dosja e forenzikës ku përshkrimi i dhënë për derën pikërisht xhamin e thyer të shtëpisë së të dëmtuarës është i njëjtë me gjendjen të cilën e ka hasur Njësia e Forenzikës gjatë procedurës së shiqimit të vendit të ngjarjes e pikërisht mënyrës së thyerjes së xhamit dhe materialit të derës së thyer. Po ashtu dëshmitari B. [REDACTED] X. [REDACTED] ka vërtetuar se telefonin i cili është sekuestruar nga ai, e ka blerë nga i akuzuari M. [REDACTED] Q. [REDACTED] nga deklarata e të dëmtuarës H. [REDACTED] T. [REDACTED] rezulton se njëri nga dy telefonat që i janë vjedhur atë natë ka qenë telefoni i cili është konfiskuar nga B. [REDACTED] X. [REDACTED] dhe të cilin e ka ble ai nga i akuzuari, kështu Prokurori i shtetit ka konsideruar se në veprimet e të akuzuarit qëndrojnë elementet esenciale të veprës penale të grabitjes nga neni 329 par.1 i KP-së, nga se në shtëpinë e të dëmtuarës paraprakisht i pandehuri M. [REDACTED] duke u dakorduar me të miturin L. [REDACTED] duke përdorur forcën kanë hyrë në shtëpinë, këtu i akuzuari është maskuar, kanë qenë të pajisur me një thikë dhe para se të përvetësojë në mënyrë të kundërligjshme të mirat materiale e kanë kanosur seriozisht të dëmtuarën me jetë po ashtu edhe e kanë detyruar të njëjtën që të tregojë se ku i mbanë gjërat me vlerë, pastaj të gjitha gjërat që kanë qenë me vlerë i kanë gjetur, i kanë përvetësuar janë larguar nga vendi i ngjarjes, e para se të largohen përsëri e kanë kanosur të dëmtuarën duke thënë që të mos guxojë ta njoftojë policinë për këtë rast. I ka propozuar gjykatës të njëjtin ta shpall fajtorë për këtë vepër penale dhe t'ia shqiptojë dënimin e paraparë me ligj në kufi të minimumit dhe të maksimumit të lejuar ligjor.

Mbrojtësi i të akuzuarit avokati V. [REDACTED] O. [REDACTED] në fjalën e tij përfundimtare gjatë shqyrtimit gjyqësor ka dekluaruar se në administrimin e provave në këtë çështje penale në mënyrë bindëse nuk është vërtetuar se i këtu i akuzuari M. [REDACTED] Q. [REDACTED] ka kryer vepër penale për të cilën akuzohet. Prokuroria pretendon se M. [REDACTED] Q. [REDACTED] nuk është bashkëkryerje me të miturin L. [REDACTED] L. [REDACTED] pas një marrëveshje paraprake ndërmjet veti kanë kryer veprën penale të grabitjes të përshkruar si në dispozitiv të aktakuzës. Ky qëndrim i prokurorisë nuk është vërtetuar me asnjë provë të administruar



• 8981 274 - 830001

• 8981 274

• 8981 274
• 8981 274

• 8981 274

• 8981 274

• 8981 274

• 8981 274

• 8981 274

• 8981 274

• 8981 274

• 8981 274

• 8981 274

• 8981 274

• 8981 274

• 8981 274


• 8981 274

e këtë duke u bazuar edhe në çështjen përgatitore të përfunduar ndaj të miturit L. [REDACTED] i cili
në atë procedurë në asnjë rrethanë nuk e ka lakuar emrin e të akuzuarit M. [REDACTED] që së bashku
kanë marr veprime kriminale ashtu siç përshkruhet në aktakuzën e prokurorisë. Në këtë çështje
penale është dëgjuar edhe e dëmtuara e cila nuk ka bërë identifikimin e personit të dytë
bashkëkryerës në këtë vepër penale, mirëpo e njëjtë ka dhënë përshkrim interesante me të cilën
konsiderojmë se e liron nga përgjegjësia penale të akuzuarin M. [REDACTED] E dëmtuara ka
dekluaruar se kryerësi i dytë i cili ka vendosur një palë çorape në kokën e tij dhe ka mbajtur një thikë
në fytin e saj ka qenë me gjatësi trupore më i shkurt se i mituri të cilin ajo identifikon. Kjo vjen të
theksohet 'pasi që në këtë çështje penale edhe u pamundësua ballafaqimi me të miturin për të
vërtetuar një gjendje faktike edhe në bazë të përshkrimit të dëmtuarës. E dëmtuara po ashtu në
deklarimin e saj ka theksuar se gjatë kryerjes së veprës në bashkëbisedim është përmendur emri
O. [REDACTED] tani më kjo mund të aludojë në atë se edhe skenari është përgatitur paraprakisht, mirëpo në
asnji rrethanë nuk bën identifikimin e çfarëdo mënyre të akuzuarit M. [REDACTED] Prokuroria
konsideron se ka anashkaluar një fakt se me rastin e kryerjes së hetimeve operative nga ana e
policisë në vendin e ngjarjes janë gjetur disa dokumente identifikuuese të personave të caktuar të cilët
e dëmtuara edhe e ka identifikuar e duke pas parasysh se e dëmtuara ka thënë se nga personat të cilët
është kryer grabitja kanë ditur për rrethanat familjare së saj se fëmijët e saj jetojnë në botën e
jashtme dhe gjendja e saj financiare është e mirë, duke i kërkuar edhe paratë, kjo tregon se i
akuzuari M. [REDACTED] i cili jeton në një lagje krejt tjetër të P. [REDACTED] nuk ka qenë në dijeni e as që
ka mundur të dijë për këto rrethana të cilët i ka sqaruar e dëmtuara. Prokuroria edhe një herë
aktakuzën e mbështet në deklaratën e të akuzuarit të dhënë në polici me ç' rast mbrojtja edhe një
herë konsideron se kjo deklaratë nuk mund të shërbejë e vetme për një vepër kaq të rëndë penale e të
mos mbështetet në asnjë provë tjetër relevante. Kjo për faktin se vet i akuzuari ka dhënë vërejtjet e
saja gjatë përpilimit të kësaj deklarate duke theksuar edhe një herë se zyrtarët policor nuk e kanë
përfshire deklaratën e dhënë për këtë çështje penale. Deklarata e të akuzuarit është ajo e cila është
dhënë në prokurori të shtetit dhe këtu gjatë shqyrtimit gjyqësor me të cilën i akuzuari ka dekluaruar se
as që e njeh të miturin L. [REDACTED] as që e ka parë ndonjëherë të dëmtuarën H. [REDACTED]
në jetën e tij. Lidhur me çështjet e telefonit të sekuestruar e cila është gjetur në posedim të akuzuarit,
i akuzuari ka shpjeguar rrethanat se si ka ardhur deri në posedimin e këtij telefoni, të cilën e ka blerë
nga A. [REDACTED] prokuroria gjatë fazës hetimore aktakuzën e ka përfunduar vetëm me faktin e
posedimit të telefonit e jo edhe mënyrën se si ka ardhur deri te i akuzuari ku është përmendur emri
komplet i personit që ka të bëj me këtë telefon. Duke pas parasysh se në asnjë provë nuk është
vërtetuar gjendja faktike e përshkruar si në dispozitiv të aktakuzës se i akuzuari M. [REDACTED] ka
kryer veprën penale të grabitjes nga neni 329 par.1 të KP, i ka propozuar trupit gjykues që në
mungesë të provuarit të akuzuarit M. [REDACTED] t'i lirojë ngaakuza dhe njëkohësisht t'i ndërpriten
masën e paraburgimit.

I akuzuari M. [REDACTED] gjatë seancës së shqyrtimit kryesor ka dekluaruar se nuk e pranon
fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës së PTH-së.

Gjykata gjatë shqyrtimit kryesor i ka nxjerrë të gjitha provat e domosdoshme dhe pas
vlerësimit të secilës prove veç e veç dhe të gjitha provave në tërësi ka vërtetur këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari M. [REDACTED] Me datë 01.shkurt 2017, rrëth orës 04:00
në Prižren në rr. " [REDACTED], i dyshuar duke përdorur forcën dhe kanosjen, sulmojnë në
shtëpinë e saj viktimën H. [REDACTED] me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të dobisë
pasurore për vete, në atë mënyrë që në bashkëveprim me të miturin L. [REDACTED] duke ditur që
viktima jeton vetëm, hyjnë në shtëpinë e të dëmtuarës duke kapërcyer murin rrethues të oborrit, e
duke depërtuar brenda shtëpisë, pasi që thyejnë xhamin e derës së hyrjes, ku në korridore hasin të
dëmtuarën të cilës i mituri L. [REDACTED] ia mbyll gojën, ndërsa i pandehuri M. [REDACTED]
fillimisht në kokën e vet e qet një çorapë, afrohet te viktima dhe me një thikë në dorë e kërcënnon dhe




TOP

i aftron të njëjtën në qafë duke i thënë se do ta mbysim dhe nga e njëjta marrin unazat, një byzylyk dhe vathët që të gjitha të floririt, e pas kontrollimit dhe demolimit të shtëpisë arrijnë të marrin edhe një shumë të hollash prej 6.000 euro (gjashtë mijë euro) një fotoaparate, dy telefona mobil dhe më pas largohen nga shtëpia.

Për vërtetimin e gjendjes faktike gjykata ka dëgjuar si dëshmitarë, të dëmtuarën H. [REDAKTUE] T. [REDAKTUE], dhe dëshmitarin B. [REDAKTUE] Gj. [REDAKTUE], dhe ka nxjerë edhe provat e tjera materiale dhe atë ka bërë leximin e: Vërtetimit mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve të dt.03.05.2017, Dosjen e forenzikës TK-[REDAKTUE] 2017, ku bën pjesë raporti i dokumentimit të telefonit të sekuestruar, Raporti mjekësor i Qendrës Emergjente të Spitalit Rajonal në Prizren nr. [REDAKTUE] të dt.02.02.2017 në emër të H. [REDAKTUE] T. [REDAKTUE]; Raportin mbi dëmin PP/I.nr. [REDAKTUE] 2017, Raportin e oficerit 2017-GA-[REDAKTUE] dt.03.05.2017, të përpiluar nga oficeri A. [REDAKTUE] B. [REDAKTUE], Propozimin për shqiptimin e masës edukative PPM.nr. [REDAKTUE] 2017 dhe fotoalbumi 2017-GA-[REDAKTUE] prej faqes 1 deri në faqen 23.

Gjendja faktike është vërtetuar edhe nga deklarata e të dëmtuarës H. [REDAKTUE] T. [REDAKTUE] e cila gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se i kujtohet që më 15.02.2017 ka dhënë një deklaratë në prokurori dhe se qëndron pranë asaj deklarate, kjo deklaratë i është marrë në prezencën e përkthyesit. Fillimisht ka deklaruar se është dëgjuar dhe ka dhënë deklaratë në prokurori, të cilën nuk e kishte nënshkruar, por në momentin kur prokurorja e shtetit e kishte ballafaquar me procesverbalin ku ishte marrë në pyetje, të cilin edhe e kishte nënshkruar, të cilin pasi e kishte shikuar kishte deklaruar se nënshkruinet e vendosura në secilën faqe ishin të saja. Më tej, ka deklaruar se më 01.02.2017 ka qenë diku ora tretë 04:00 e mëngjesit, kishte dëgjuar një zhurmë në oborrin e shtëpisë, dhe kishte dal në oborr, askush nuk kishte qenë në oborr, përsëri ishte kthyer në shtrat dhe përsëri kishte dëgjuar edhe një zhurmë tjetër, kur ishte zgjuar kishte parë që një pjesë e xhamit te dera e korridorit ka qenë e thyer, i ka mbledh xhamat në korridor, përsëri ishte kthyer në shtrat, pasi kishte menduar se era e kishte thyer xhamin, për së treti herë kur është zgjuar i ka parë dy djem të riqë në shtrat përmbi të, njëri ia kishte mbyllur gojën dhe e kishin qit në korridor, dhe i kishin thënë "nxjerri paret se i ki dy djemtë në botën e jashtme" njëri e kishte mbajt kurse tjetri kishte filluar me hallakat-kontrollu në krejt shtëpinë. Telefonin fiks ia kishin këputur dhe ia kishin marrë dy telefonat mobil, se cili nga këta djemtë ja kishte marrë nuk i kujtohet, gjithashtu ia kishin marrë byzylykun, dy unazat, vathët dhe një zinxhir. Përpos të sendeve të lartekura ata ia kishin marrë edhe 6000 euro dhe 100 euro që i mbante në kuzhinë, pra gjithsej 6100 euro, se e ka pasur një shumë të tillë të hollash në shtëpi e dëmtuara ka dëshmuar me vërtetimin e datës 24.04.2014, ku vërtetohet se T. [REDAKTUE] H. [REDAKTUE] është paguar në një të gjysmës sipas listës poseduese nr. [REDAKTUE] ZK B. [REDAKTUE] dhe se pasuria në tërësi i është paguar dhe nuk ka kurrfarë kërkesa sipas të njëjtës, kjo pagesë është bërë me datën 20.04.2014 në ora 14:00 në shumën prej 13.500 euro. Gjithashtu të dëmtuarës ia kishin marrë edhe një zinxhir të arit nga arka e bizhuterisë, të cilën e kishin sjellë para të dëmtuarës dhe e kishin zbrazur edhe pse e dëmtuara iu kishte thënë se bizhuteritë në arkë ishin nga 1 euro, por ata e kishin zbrazur dhe nga ata aty e kishin marrë yetëm zinxhirin e arit ndërsa bizhuteritë e tjera i kishin kthyer prapë në arkë dhe e kishin pyetur se "si ju nuk keni para kur dy djem i keni duke punuar jashtë vendit". Për këtë zinxhir që i është marrë nga arka ku i mbante bizhuteritë ka deklaruar se nuk i kishte treguar prokuores pasi që në ato momente derisa e kishte dhënë deklaratën nuk i është kujtuar. Përderisa njëri po e mbante të dëmtuarën tjetri kishte shkuar herë në katin lartë e herë në katin poshtë dhe e kishte kontrolluar krejt shtëpinë. Pastaj njëri nga ta ia kishte marrë hullaopkat e saj dhe i kishte vendos në kokë dhe ishte maskuar ndërsa personi tjetër nuk ishte i maskuar, personi tjetër që shkonte herë andej e herë këndeje e ka pas briskun në dorë dhe i kishte thënë "a bon me ma dhonë një shkrepës se po du me dhez një drogë", kjo ishte ngrit ia kishte dhënë shkrepës, pastaj kur kanë dasht me dal, njëri nga ta tha "hajde po ja marrim edhe telvizorin plazma", pastaj kjo i kishte thënë këtyre djemeve "a skeni ju shpirt a skeni nona", njëri nga ta ia kishte kthyer "nana kemi por pare skemi". Personi i cili e mbante poshtë të dëmtuarën kur kishte filluar me zbardh drita i kishte thënë atij personit që ndodhej në katin lartë "hajde O. [REDAKTUE] se jemi vanu, se ka fillu mu zdrift-zbardhë". Sa i përket përshkrimit fizik për këtë



personi e maskuar ka deklaruar se ka qenë një djalë i ri, ndërsa ai djali që e kishte mbajtur të dëmtuarën kishte qenë edhe më i ri dhe më i gjatë se ai tjetri. Më pastaj kishin dal, televizorin nuk e kishin marrë dhe kësaj i kishin thënë "mos gabu mu u qu me i lajmëru dikujt se kemi me të pre" dhe ishin larguar, kjo pas 10 minutash kishte dal në oborr dhe kishte shkuar te kojshia që ta lajmëroj policinë dhe nuk kishte shkuar as 10 minuta policia kishte ardh. Tërë kjo ngjarje kishte zgjat më tepër se gjysëm ore, dhe se nuk e dinte nëse ka mundur ta kryejë këtë vepër ndonjë i afërm i familjes së saj që i din rrëthanat e saja familjare. Në polici gjatë identifikimit e ka njojur vetëm atë personin(të miturin) i cili ia kishte mbajt gojnë të mbyllur, i cili nuk kishte pas maskë, ndërsa personin tjetër nuk e kishin sjellë, pastaj policia e kishin njoftuar se në rrugë e kanë gjetur një telefon ndërsa ndonjë dokument të dikujt nuk i kishin gjetur ndërsa vet ka shtuar se këto gjëra nuk i parë afër shtëpisë së saj, por policia e kishte njoftuar se i kishin gjetur ato, ndërsa ia kishin treguar edhe një fotografi në telefon dhe e kishin pyetur se a e njeh këtë person, në atë moment nuk i është kujtuar se kush ishte, ndërsa një kojshi i saj i kishte thënë e "si ishte e mundur që nuk e njihni këtë person". Në fund ka deklaruar se ka qenë shumë e frikësuar dhe gjithashtu ka pasur shenja në duar kur ia kishin heq hallkën-byzylykun nga dora, për çka edhe e kishin dërguar policia në spital, dhe se parashtron edhe kërkesë pasurore juridike.

Dëshmisi së kësaj deklarate të dhënë nga e dëmtuara-dëshmitarja gjatë shqyrtimit gjyqësor gjykata ia fali besimin, pasi kjo dëshmi është në përputhje edhe me provat që janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor.


Dëshmitari B. G. gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se M. Q. njeh sepse me vëllain e tij kishte punuar shumë, gjithashtu edhe me M. kishte punuar një muaj në autolarje. Ndërsa sa i përket telefonit të tipit "Samsung" të cilin policia e kishin gjetur tek ky, e kishte blerë nga M. Q. në shumën 2 euro, koha saktësisht nuk i kujtohet por e dinë se ka qenë vera, data 20 apo 21 Qershor aty pari. Me M. ishin takuar në lokalini ku ky punonte në lagjen "P." aty afër në një lokal tjetër ka punuar edhe M. këto dy lokale janë ngjit me njëri tjetrin dhe se gjatë blerjes së atij telefoni nuk kishin diskutuar asgjë por vetëm e kishte blerë, kështu se nuk kishte qenë në dijeni se ky telefon ka qenë i vjedhur.

Gjykata dëshmisi së këtij dëshmitari, ia fali besimin pasi që është në përputhje edhe me provat e tjera të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, dhe nga dëshmia e këtij, dëshmitari është vërtetuar se telefonin "samsung", i cili është grabitur nga e dëmtuara natën kritike e kishte blerë nga i akuzuari Mërgim, vërtetohet edhe nga deklarata e këtij të fundit i cili kishte pranuar në mbrojtjen e tij se ia kishte shitur këtë telefon këtij dëshmitari.

Nga leximi i vërtetimit mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve të datës 03.05.2017 është vërtetuar se zyrtari policor A. B. kishte konfiskuar përkohësisht një celular "samsung", modeli SGH-X160, me nr të Imët 35599202286822, i cili ishte gjetur te qytetari B. G.

Nga dosja e Forenzikës TK-2017, ku bënë pjesë edhe raporti i dokumentimit të telefonit të sekuestruar është vërtetuar se më 03.05.2017, rrëth orës 12:40 min, nga hetuesi policor A. B. i është bërë dokumentimi i një telefoni cellular të sekuestruar nga M. Q. i lindur më 18.09.1995. Dokumentimi i telefonit cellular që është sjellë nga hetuesi A. B. i është bërë në zyrën e teknikës kriminalistike katër i dytë nr.12. Nga ky dokumentim ka rezultuar se telefoni cellular "Samsung" me kapak të ngjyrës së kuqe është evidentuar si dëshmia A1 është dokumentuar me fotografim dhe më pas është paketuar në mënyrë adekuatë me qese plastike.

Nga leximi i raportit mjekësor i Qendrës Emergjente të Spitalit Rajonal në Prizren nr. dt.02.02.2017, në emër të H. T. është vërtetuar se persona të panjohur kanë hyrë në shtëpinë e të dëmtuarës për të vjedhë dhe si pasojë e kësaj e dëmtuarë është konstatuar se ka shenja




të ndrydhjes si pasojë e shtrëngimit me duar siç ka dekluar pacientja- e dëmtuara, shenja tjera të dallueshme nuk ka.

Nga raporti mbi dëmin PP/I.nr.62/2017, është vërtetuar se të dëmtuarës i është mbyllur goja dhe i janë marrë me dhunë hallkat nga dora. Me rastin e depërtimit në shtëpi ia kanë thyer derën dhe ia kanë grabitur stolitë në vlerë prej 6000 euro.

Nga raporti i oficerit 2017-GA-**[REDAKTUE],** dt.03.05.2017, të përpiluar nga oficeri A**[REDAKTUE]** B**[REDAKTUE]** është vërtetuar se pas aplikimit të masave të fshehta të përgjimit dhe telekomunikimit lidhur me këtë rast, kështu duke përgjuar dy imei të telefonave që i ishin grabitur të dëmtuarës në shtëpinë e saj, kanë arritur të identifikojnë edhe telefonin e dytë Samsung, Modeli SGH-X160, i cili mbyllët dhe hapet me kapak, me ngjyrë të kuqe dhe të zezë, i modelit të vjetër dhe me këtë rast e ka identifikuar edhe të dyshuarin e dytë si pjesëmarrës në rastin e grabitjes së bashku me të dyshuarin e mitur L**[REDAKTUE]** I**[REDAKTUE]** Nga hetimet ka rezultuar se telefoni i grabitur ishte në përdorim të B**[REDAKTUE]** Gj**[REDAKTUE]** i cili ishte intervistuar në cilësi të dëshmitari dhe kishte dekluar se këtë telefon e kishte blerë para dy jave nga M**[REDAKTUE]** Q**[REDAKTUE]** të cilin e njihet mirë. Pas marjes së deklaratës ky dëshmitar është liruar dhe i është konfiskuar telefoni për të cilin konfiskim është lëshuar edhe fletë dëshmia për konfiskim. Po ashtu ishte intervistuar edhe i dyshuarri M**[REDAKTUE]** Q**[REDAKTUE]** në prezencën e mbrojtësit të tij të caktuar sipas detyrës zyrtare, i cili gjatë deklaratës së tij ndër të tjera kishte dekluar se ka qenë pjesëmarrës në rastin e kryerjes së kësaj vepre penale së bashku me I**[REDAKTUE]** L**[REDAKTUE]**.

Nga leximi i propozimit për shqiptimin e masës edukative PPM.nr. 34/2017 është vërtetuar se Prokuroria Themelore në Prizren-Departamenti për të mitur, më dt. 22.03.2017 ka ngritur propozimin për shqiptimin e masës edukative ndaj të mituri I**[REDAKTUE]** L**[REDAKTUE]** i cili në bashkëkryerje ka kryer veprën penale të grabitjes nga neni 329 par.1 lidhur me nenin 31 të KP.

Nga shikimi në fotoalbumin 2017-GA-0216 prej faqes 1 deri në faqen 23 është vërtetuar kjo gjendje: në fotografinë e nr.1 shihet "_____" në P**[REDAKTUE]**, ku kishte rasti, në fotografinë nr.2 shihet dera e hyrjes së oborrit e hapur e pa dëmtuar, në fotografinë nr.3 shihet dera e hyrjes së shtëpisë, krahu i majtë i derës dhe një xham i thyer i derës, në fotografinë nr.4 shihet xhami i thyer i derës, në fotografinë nr.5 shihen copëzat e thyera të xhamit në oborr, në fotografinë nr.6 shihet korridori i katit të parë, në fotografinë nr.7 shihen copëzat e xhamit të thyer në dysheme, në fotografinë nr.8 shihet dera e hyrjes, xhami i thyer në derë që është evidentuar me dëshminë me numër 1, nga fotografia nr.9 shihet xhami i derës së hyrjes në shtëpi që është i thyer, në fotografinë nr.10 shihet pjesa e vendit ku ka qenë xhami i cili ishte i thyer, që është fotografuar edhe me njësi matëse, në fotografinë nr.11 shihet korridor i katiti të parë të shtëpisë, në fotografinë nr.12 shihen paisjet e demoluara nëpër dysheme, në fotografinë nr.13 shihet korridori, dhoma që shfrytëzohej si depo e demoluar, në fotografinë nr. 14 shihet pjesa e dytë e korridorit në katin e parë, në fotografinë nr.15 shihet dera e dhomës së parë në të majtë nga dera e hyrjes, dhoma që shfrytëzohej si sallon-kuzhinë, në fotografinë nr.16 shihet brendia e sallonit të kuzhinës të demoluar pjesërisht, në fotografinë nr.17 dhe nr.18 shihet brendia e sallonit të demoluar, në fotografinë nr. 19 shihet salloni, televizori të cilin të dyshuarit e kishin heq nga rryma, në fotografinë nr. 20 shihet korridori pjesa e dytë e korridorit në katin e parë të shtëpisë, në fotografinë nr. 21 shihet dera e dhomës që është në korridorin e katiti të dytë e cila dhomë ishte në të majtë nga hyrja e korridorit, në fotografinë nr. 22, 23 dhe 24 shihet brendia e dhomës së demoluar tërësisht, në fotografinë nr. 25 shihet ana e djathë e korridorit të dytë ku kishte demolimë, në fotografinë nr. 26 shihet demolomi në korridor, në fotografinë nr.27 shihet dera e shkallëve që të dërgon për në katin e dytë, në fotografinë nr.28 shihen shkallët që të shpien për në katin e dytë, në fotografinë nr.29 në fotografinë shihet korridori i katit të dytë, nr.30 shihet dera e dhomës e para në të djathë nga shkallët, në fotografinë nr. 31 shihet brendia e dhomës e pa demoluar, në fotografinë nr. 32 shihen orëndështë në dhomë të pa demoluar, në




107

fotografitë nr.33, 34 dhe 35 shihet dera e dhomës e cila ka lidhmëri me dhomën që është parë në të djathtë nga shkallët, në brendi të kësaj dhome nuk ka demolim, po ashtu edhe rregalli ishte i pa hapur, i pa demoluar, në fotografinë nr.36, 37 dhe 38 shihet dera e dhomës që është në të majt nga shkallët e korridorit, po ashtu shihet edhe brendia e dhomës ku rregalli në këtë dhomë i cili kishte rrrobë ishte demoluar nga të dyshuarit, në fotografinë nr. 39 shihet muri i mbuluar me tjegulla, muri në pjesën mbi derën ë hyrjes së oborrit ku kishte bore dhe shihen disa gjurmë të këpucëve, në fotografinë nr.40, 41 dhe 42 shihen gjurmët e këpucëve të cilat gjurmë nuk kishin karakteristika, të cilat janë evidentuar me numër dëshmues 2, këto gjurmë janë fotografuar me numër dhe njësi matëse, në fotografinë nr.43 shihet rruga "████████", ku është gjetur një telefon mobil, rreth 20m larg nga vendi i ngjarjes, në fotografinë me nr.44 dhe 45 shihet dera me numër 10 ku para derës është një telefon, në fotografinë me numër 46 shihet telefoni mbi borë, në fotografinë me nr.47, 48 dhe 49 shihet telefoni që është evidentuar me numër dëshmje 3, në fotografitë me numër 50 dhe 51 shihet pjesa e pasme e telefonit që kishte një fatroll plastike të tejdukshme dhe brenda ishte një letërnjoftim me numër personal ██████████.

I akuzuari M. ██████ gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë me aktakuzë, ndërsa në mbrojtjen e tij ka deklaruar se ka dhënë një deklaratë në polici dhe prokurori lidhur me rastin që kishte ndodh më 01.02.2017, për çka akuzohet se ky bashkë me të miturin L. ██████ ka kryer një grabitje, por ka deklaruar se nuk qëndron pranë deklaratës së dhënë në polici, kjo pasi që kur është marrë në pyetje në polici avokati i tij nuk ka qenë prezent dhe se ky i fundit kishte ardhur pasi që ky e kishte përfunduar deklaratën e tij, të cilit ia kishte treguar se si kishte qenë rasti. Ndërsa deklaratën që e kishte dhënë në prokurori e ka dhënë në prezencë të avokatit. Po ashtu ka deklaruar se L. ██████ nuk e njeh dhe se telefonin e vjedhur të cilin ia kishte shitur dëshmitarit B. ██████ G. ██████ ka marrë nga A. ██████ B. ██████ i cili ia kishte fal të akuzuarit dhe se nuk i kishte treguar se ku e kishte marrë këtë telefon vetëm se i kishte thënë "po du me ta fal këtë telefon". Këtë telefon nuk i kujtohet data e saktë se kur ia kishte fal, por i kujtohet se ka qenë vera kur A. ██████ B. ██████ kishte ardh te i akuzuari ia kishte lënë veturën dhe i kishte thënë "a mundesh me ardh deri te une", dhe të dy kishin shkuar në shtëpinë e tij bashkë me të akuzuarin dhe aty ia kishte fal telefonin. Më tej ka deklaruar se A. ██████ B. ██████ është afér 30 vjeç, është nga T. ██████ dhe se nuk ka kurrrfarë raportesh me atë. Ka shtuar se nuk është përdorues i lëndëve narkotikë. Në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se pajtohet në tërësi me fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij dhe ka shtuar se sa i përket L. ██████ nuk e njeh, nuk ka të bëj fare me këtë rast, ka kërkuar që të shpallet i pafajshëm.

Gjykata duke analizuar mbrojtjen e të akuzuarit të njëjtës nuk ia fali besimin pasi që i akuzuari në mbrojtjen e tij në tërësi është mundur që ti shmanget përgjegjësisë penale, dhe se mbrojtja e tillë e dhënë është në tërësi në kundërshtim me të gjitha provat materiale si dhe me dëshmitë e të dëmtuarës dhe dëshmitarit të cilët janë dëgjuar gjatë shqyrtimit kryesorë. Në të vërtetë i akuzuari e ka pranuar se telefonin Samsung ia ka shitur dëshmitarit B. ██████ G. ██████ duke u arsyetuar se këtë telefon ia kishte dhuruar një person me emrin A. ██████ B. ██████ ne të cilin sipas tij nuk kishte kurrrfarë raportesh por veç ia kishte dhuruar pa asnjë arsy, për qka gjykata nuk ia fali besimin se telefonin ia kishte fal A. ██████ B. ██████ kjo pasi që me këtë të fundit i akuzuari nuk ka kurrrfarë raportesh shoqërore dhe përderisa nuk ka rapportet shoqërore është e pa qartë se si ka mundur të shkoj në shtëpinë e një personi të panjohur dhe ta marrë telefonin të cilin ka deklaruar se ai ia ka falur, si dhe as nuk e dinte arsyen se pse i është falur ky telefon. I akuzuari në deklaratën e tij të cilën e ka dhënë në polici në prezencën e mbrojtësit të cilën deklaratë edhe vetë ka nënshkruar në tërësi e ka pranuar kryerjen e kësaj vepre penale, duke e përshkruar se si ka rrjedhur ngjarja ditën kritike.



4500 - 4600

4600 - 4700

4700 - 4800

4800 - 4900

4900 - 5000

5000 - 5100

5100 - 5200

5200 - 5300

5300 - 5400

5300 - 5400

5400 - 5500

5500 - 5600

5600 - 5700

(

5700 - 5800

Gjendja faktike është vërtetuar edhe nga provat e tjera e në veçanti nga raporti i oficerit 2017-GA-**Q** dt.03.05.2017, prej nga vërtetohet se telefoni i tipit "samsung" që i është grabitur të dëmtuarës është gjetur tek dëshmitari B.**Xh.** i cili ka dekluaruar se e kishte blerë nga i akuzuari M.**Q.** për vetëm 2 euro, ky i fundit edhe e ka pranuar se ia ka shitur telefonin.

Gjykata në rastin konkret konstatoi se nuk është kontestuese dhe në tërësi është vërtetuar se se i akuzuari M.**Q.** duke përdorur forcën dhe kanosjen, bashkë me të miturin L.**L.** ditën kritike në orët e mëngjesit diku rrëth orës 04:00, pasi që kapërcejnë murin e oborrit, fillimisht e thejnë xhamin e derës së shtëpisë së të dëmtuarës nga ku edhe e hapin derën e shtëpisë futen brenda në shtëpi dhe pasi që fillimisht ia mbyllin gojën të dëmtuarës dhe ia marrin unazat, byzylykët, vathët që të gjitha nga floriri dhe 6000 euro, një foto aparat si dhe dy telefonë mobil pastaj largohen nga shtëpia e të dëmtuarës, njërin nga këta telefonë përkatesisht telefonin Samsung i akuzuari M.**Q.** ia shet dëshmitarit B.**Gj.**

Gjykata, pas administrimit dhe vlerësimit të provave, padyshim ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit qëndrojnë elementet e veprës penale të grabitjes nga neni 329 paragrafi 1 të KP, prandaj edhe të njëtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin konform nenit 73 të KP, përkitazi me llojin dhe lartësinë e dënit, gjykata vlerësoi të gjitha rrëthanat të cilat ndikojnë në të njëtin duke marrë parasysh qëllimin e dënit, të gjitha rrëthanat të cilat ndikojnë në zbutjen apo irritjen e dënit, shkallën e përgjegjësisë penale. Gjykata si rrëthana lehtësuese ka vlerësuar, moshën relativisht të re të akuzuarit, sjelljen e tij gjatë seancave gjyqësore si dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit. Gjykata vlerëson se me dënimin e shqiptuar ndaj të akuzuarit do të mund të arrihet qëllimi i dënit i paraparë me nenin 41 të KP-së në të gjitha segmentet e tij. Dëni i shqiptuar për ka lloji dhe lartësia është në harmoni me rrëthanat e rastit, të nevojshme dhe të mjafueshme për tu arritur qëllimi i dënit konform dispozitës së lartcekur. Dëni i shqiptuar për të akuzuarin sipas gjetjes së gjykatës është në harmoni dhe në baraspeshë me peshën e veprës së kryer penale dhe se kur të merret parasysh shkalla e dëmtimit të vlerës së mbrojtur, mënyra dhe rrëthanat e kryerjes së veprave penale, dëni i tillë paraqitet si i domosdoshëm me qëllim të arritjes së qëllimit të dënit, me to shprehet gjykimi i shoqërisë për shkak të veprës së kryer penale dhe forcohet obligimi i respektimit të ligjit.

Vendimi mbi kërkesën pronësoro juridike është marrë në bazë të nenit 463 par.2 të KPP të Kosovës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në bazë të nenit 450 të KPP të Kosovës.

Si u cekë edhe më lart u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN,
P.nr. 87/2017 më datë 05.12.2017

Procesmbajtësja
Birsen Küme



Kryetari i trupit gjyku
Skender Coçaj

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palë pa kënaqur ka të drejtë ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes se njëtit, Gjykatës se Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.